Prokuroritë themelore dhe PSRK-ja, gjatë viteve 2013-2019, kanë pranuar nga subjektet e ndryshme **6440**, persona (në Informatat PPN), për veprat e pretenduara penale karakteristike, ndërsa kanë mbyllur **5575**, raste për persona apo **86.57%** (shih figurën 37). Prokuroria Themelore në Prishtinë është prokuroria e vetme e cila ka mbylluar më shumë raste për persona në raport me numrin e rasteve të pranuar për persona (shih figurën 38).

	2013			2014			2015			2016			2017			2018			2019			TOTAL:		
	Pranuar	Mbyllur		Pranuar	Mbyllur		Pranuar	Mbyllur		Pranuar	Mbyllur		Pranuar	Mbyllur		Pranuar	Mbyllur		Pranuar	Mbyllur		Pranuar	Mbyllur	
		Nr.	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%
A	23						1	1	100%						2	23	1150%	1			27	24	88.89%	
DR	21	8	38%	30	12	40%	16	4	25%	34	19	55%	30	26	87%	34	45	132%	39	49	126%	204	163	79.90%
KM	23	4	17%	22	2	9%	15	2	13%	1	1	100%	1	1	100%		44		5	6	120%	67	60	89.55%
KO	4			24	7	29%	8	4	50%	15	13	87%	10	10	100%	9	27	300%	93	49	53%	163	110	67.48%
KORR	331	133	40%	372	281	76%	548	336	61%	705	457	65%	721	813	123%	746	913	122%	914	967	106%	4337	3900	89.92%
SHP	48	25	52%	33	20	61%	37	20	54%	56	15	27%	26	18	69%	30	121	403%	86	78	91%	316	297	93.99%
TNJ	13	6	46%	12	7	58%	18	8	44%	4	7	175%	5	7	140%	3	2	67%	16	16	100%	71	53	74.65%
E				37	12	32%	113	74	65%	165	112	68%	251	219	87%	275	201	73%	414	350	85%	1255	968	77.13%
NU																								
	463	176	38%	530	341	64%	756	449	59%	980	624	64%	1044	1094	105%	1099	1376	125%	1568	1515	97%	6440	5575	86.57%

Figura 37

	PSRK			PRISHTINE			PRIZREN			PEJË			GJILAN			MITROVICË			FERIZAJ			GJAKOVË		
	P	M	%	P	M	%	P	M	%	P	M	%	P	M	%	P	M	%	P	M	%	P	M	%
A	23	21	91%	1			2	2	100%										1	1	100%			
DR	4	4	100%	1	1	100%	11	6	55%	141	123	87%	18	13	72%	15	4	27%	12	10	83%	2	2	100%
KM	46	48	104%	1			4	4	100%	4	2	50%	2	0		5	4	80%	5	2	40%			
KO	160	110	69%							1									2	0				
KORR	662	553	84%	1904	1990	105%	387	318	82%	666	541	81%	85	71	84%	171	76	44%	272	227	83%	190	124	65%
SHP	310	294	95%				2	2	100%	1			1	1	100%	2	0							
TNJ	3	1	33%	4	4	100%	11	7	64%	23	19	83%	12	5	42%	2	1	50%	14	14	100%	2	2	100%
E	9	8	89%	317	248	78%	89	49	55%	504	370	73%	20	18	90%				309	269	87%	7	6	86%
NU																								
TOTAL:	1217	1039	85%	2228	2243	101%	506	388	77%	1340	1055	79%	138	108	78%	195	85	44%	615	523	85%	201	134	67%

Figura 38

3.5 TRENDI I NGARKESËS ME PERSONA: 2013-2019

Ngarkesa me persona (në Informatat PPN), në fund të vitit 2019, është rritur për 31 persona **2.07%** në raport me vitin paraprak. Ngarkesën më të lartë me persona në fund të vitit 2019, sipas veprës penale rezultojnë të ketë Korrupsioni me **66.64%**, ndërsa sipas prokurorive, rezultojnë se P.Th.Prishtinë me **42.10%**, ka nivelin më të lartë të ngarkesës me Informata PPN *shih figurën 39 & 40*).

		2013	2013 vs 2014	2014	2014 vs 2015	2015	2015 vs 2016	2016	2016 vs 2017	2017	2017 vs 2018	2018	2018 vs 2019	2019
1	A	27	-1	26	0	26	0	26	0	26	-21	5	-1	4
2	DR	23	+18	41	+12	53	+15	68	0	68	-22	46	-15	31
3	KM	21	+21	42	+13	55	-4	51	+1	52	-44	8	-5	3
4	KO	6	+22	28	-2	26	+3	29	-1	28	-19	9	+40	49
5	KORR	578	+107	685	+166	851	+350	1201	-99	1102	-50	1052	-31	1021
6	SHP	45	+20	65	+10	75	+41	116	+16	132	-53	79	-4	75
7	TNJ	13	+5	18	+13	31	-6	25	-5	20	+1	21	-13	8
8	E		+28	28	+40	68	+113	181	+19	200	+81	281	+60	341
9	NU													
		713	+220	933	+252	1185	+512	1697	-69	1628	-127	1501	+31	1532

Figura 39





Figura 40

PJESA E KATËRT

4. PERFORMANCA

- PROCEDIMI I KALLËZIMEVE PENALE ME PERSONA;
- NGARKESA ME KALLËZIME PENALE DHE PERSONA;
- PROCEDIMI I RASTEVE PËR PERSONA;
- MBYLLJA E INFORMATAVE PPN ME PERSONA
- NGARKESA ME INFORMATA PPN DHE PERSONA;

4.1 PROCEDIMI I KALLËZIMEVE PENALE ME PERSONA

Prokuroria speciale rezulton të ketë nivelin më të lartë të procedimit të kallëzimeve penale (106%) dhe të personave (128%) në raport me numrin e tërësishëm të kallëzimeve penale të pranura mer persona përgjatë viteve 2013-2019, ndërsa nivelin më të ulët Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me 81% të kallëzimeve penale dhe 83% të personave (*shih figurën 41 & 42*).

# 2013 - 2019		A	DR	KM	KO	KORR	SHP	TNJ	E	NU
PSRK	Kallëzime penale	127%	147%	75%	89%	114%	115%	100%	83%	50%
	Persona	267%	138%	177%	108%	138%	139%	327%	41%	107%
PRIZREN	Kallëzime penale	106%	95%	104%		105%	33%	100%	104%	75%
	Persona	103%	95%	94%		102%	27%	100%	107%	80%
GJILAN	Kallëzime penale	73%	92%	92%		99%		85%	98%	100%
	Persona	78%	94%	87%		102%		85%	92%	33%
FERIZAJ	Kallëzime penale	113%	95%	100%		103%		90%	82%	75%
	Persona	54%	95%	100%		105%		93%	84%	64%
PEJË	Kallëzime penale		91%	80%		99%		86%	92%	78%
	Persona		91%	83%		101%		84%	91%	82%
GJAKOVË	Kallëzime penale	83%	81%	75%		98%		71%	99%	200%
	Persona	90%	87%	79%		104%		83%	91%	150%
PRISHTINË	Kallëzime penale	47%	76%	63%		94%		66%	100%	167%
	Persona	62%	76%	64%		101%		90%	97%	167%
MITROVICË	Kallëzime penale	33%	86%	86%		86%		74%	71%	25%
	Persona	67%	83%	73%		95%		101%	72%	30%

# 2013 - 2019		A	DR	KM	KO	KORR	SHP	TNJ	E	NU
Mesatarja %	Kallëzime penale	83%	95%	84%	89%	99%	74%	84%	91%	96%
	Persona	103%	94%	94%	108%	106%	83%	120%	84%	89%

Figura 41





Figura 42

4.2 PROCEDIMI (zgjidhja/kryerja) E RASTEVE PËR PERSONA

Nga tërësia e rasteve të proceduara për persona gjatë viteve 2013-2019, rezultojnë se 62.27% janë aktakuza, 37.02% hudhje të kallëzimit penale apo pushim të hetimit (*shih figurën 43*). Prokuroria themelore në Ferizaj rezultojnë të ketë performancën më të mirë në sistemin prokurorial, pasi që rezultojnë të ketë nivelin më të lartë të aktakuzave të ngritura (77.34%), si dhe nivelin më të ulët të hudhjeve/pushimit të hetimeve (21.72%), (*shih figurën 44*).

# 2013-2019	Persona	A	DR	KM	KO	KORR	SHP	TNJ	E	NU	TOTAL
PSRK	Hudhje & Pushim	21	44	56	319	337	187	21	6	8	999
	Aktakuza	27	49	98	381	288	52	28	11	24	958
	Mënyrë tjetër ³		6		18	9	4				37
PRISHTINË	Hudhje & Pushim	3	339	18		1627		27	531	3	2548
	Aktakuza	24	1786	87		792		170	557	5	3421
	Mënyrë tjetër		7			19			6		32
PRIZREN	Hudhje & Pushim	9	150	13	1	478	3	19	411	3	1087
	Aktakuza	51	1160	32	13	349		26	282	5	1918
	Mënyrë tjetër	3	12			28			12		55
PEJË	Hudhje & Pushim		96	3		342		28	113	6	588
	Aktakuza	1	640	7		168		20	113	3	952
	Mënyrë tjetër		6					1	2		9
GJILAN	Hudhje & Pushim	2	30	12		399		7	100	1	551
	Aktakuza	16	625	59		268		33	240		1241
	Mënyrë tjetër					1					1
MITROVICË	Hudhje & Pushim		100	9		189		11	218	3	530
	Aktakuza	6	790	10		245		68	176		1295
	Mënyrë tjetër		1			8			1		10
FERIZAJ	Hudhje & Pushim	5	46	5		182		8	147		393
	Aktakuza	24	763	25	2	217		74	287	7	1399
	Mënyrë tjetër		3	1		4			9		17
GJAKOVË	Hudhje & Pushim	3	46	7		174		12	56		298
	Aktakuza	1	362	16		167		22	99	3	670
	Mënyrë tjetër	5						1	1		7

Figura 43




Figura 44

³ Mënyrë tjetër nënkupton procedimin e rasteve për persona me bashkim të procedurës, transferim të procedurës në shtetit tjetër dhe masa për trajtim të detyrueshëm psikiatrik.

4.3 MBYLLJEN E INFORMATAVE PPN ME PERSONA

Prokuroria themelore në Prishtinë rezulton të ketë nivelin më të lartë të procedimit të Informatave PPN (102.34%) dhe të personave (100.67%), në raport me numrin e tërësishëm të Informatave PPN të pranuar me persona përgjatë viteve 2013-2019, ndërsa nivelin më të ulët Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me 50.88% të Informatave PPN dhe 43.59% të personave (*shih figurën 45 & 46*).

# 2013 - 2019		A	DR	KM	KO	KORR	SHP	TNJ	E	NU
PRISHTINË	Informata PPN		200%	100%		107%		100%	82%	
	Persona		100%			105%		100%	78%	
FERIZAJ	Informata PPN	100%	75%	50%		89%		91%	90%	
	Persona	100%	83%	40%		83%		100%	87%	
GJILAN	Informata PPN		81%			91%	100%	56%	89%	
	Persona		72%			84%	100%	42%	90%	
PSRK	Informata PPN	50%	100%	17%	85%	75%	79%	33%	43%	
	Persona	91%	100%	104%	69%	84%	95%	33%	89%	
PEJË	Informata PPN		82%	50%		82%		83%	75%	
	Persona		87%	50%		81%		83%	73%	
PRIZREN	Informata PPN	100%	50%	100%		84%	100%	75%	55%	
	Persona	100%	55%	100%		82%	100%	64%	55%	
GJAKOVË	Informata PPN		100%			72%		100%	86%	
	Persona		100%			65%		100%	86%	
MITROVICË	Informata PPN		43%	60%		52%		50%		
	Persona		27%	80%		44%		50%		
# 2013 - 2019		A	DR	KM	KO	KORR	SHP	TNJ	E	NU
Mesatarja %	Kallëzime penale	83%	91%	62%	85%	81%	93%	73%	74%	
	Persona	97%	78%	62%	69%	78%	98%	71%	79%	

Figura 45





Figura 46

4.4 PERFORMANCA E DALLUAR

Në bazë të parametrave matës që adresojnë mënyrën e procedimit të rasteve për persona të përfshirë në veprat penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional, siç janë: Hudhja e kallëzimit penal; Pushimi i hetimeve dhe Aktakuzat e ngritura, për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike përgjatë viteve 2013-2019, rezulton se **Prokuroria Themelore në Ferizaj** ka arritur performancën më të mirë në tërë sistemin prokurorial (*shih figurën 47 & 48*).

2013-2019	Persona të pranuar	Persona të proceduar		Hudhje e kallëzimit penal		Pushim të hetimeve		Aktakuza të ngritura	
		#	%	#	%	#	%	#	%
PSRK	1557	1994	128.07%	152	7.62%	847	42.48%	958	48.04%
PTh. Prishtinë	6794	6001	88.33%	1645	27.41%	903	15.05%	3421	57.01%
PTh. Prizren	3056	3060	100.13%	609	19.90%	478	15.62%	1918	62.68%
PTh. Pejë	1657	1549	93.48%	281	18.14%	307	19.82%	952	61.46%
PTh. Gjilan	1880	1793	95.37%	333	18.57%	218	12.16%	1241	69.21%
PTh. Mitrovicë	2214	1835	82.88%	415	22.62%	115	6.27%	1295	70.57%
PTh. Ferizaj	1955	1809	92.53%	218	12.05%	175	9.67%	1399	77.34%
PTh. Gjakovë	1054	975	92.50%	170	17.44%	128	13.13%	674	69.13%
Total:	20167	19016	94.29%	3823	20.10%	3171	16.68%	11858	62.36%

Figura 47

2013-2019	Proceduar	Hudhje/Pushim	%	Aktakuza të ngritura	%
PSRK	1994	999	50.10%	958	48.04%
Prishtine	6001	2548	42.46%	3421	57.01%
Prizren	3060	1087	35.52%	1918	62.68%
Peje	1549	588	37.96%	952	61.46%
Gjilan	1793	551	30.73%	1241	69.21%
Mitrovice	1835	530	28.88%	1295	70.57%
Ferizaj	1809	393	21.72%	1399	77.34%
Gjakove	975	298	30.56%	674	69.13%
Total:	19016	6994	36.78%	11858	62.36%

Figura 48

PËRFUNDIME

5. KONSTATIME:

1. Nga tërësia e kallëzimeve penale me persona të përfshirë në veprat penale karakteristike, të parashtuara nga subjektet e ndryshme, përgjatë viteve 2013-2019 (12538 kallëzime penale me 20167 persona), rezulton se Institucionet e specializuara shtetërore kanë parashtuar 11827 kallëzime penale apo 94.33%, me 18621 persona apo 92.33%, ndërsa qytetarët/të dëmtuarit kanë parashtuar 711 kallëzime penale apo 5.67% me 1546 persona apo 7.67%;
2. Prokuroritë, përgjatë viteve 2013-2019, kanë pranuar 12538 kallëzime penale ndërsa kanë proceduar (*kryer/zgjidhur*), 11329 kallëzime penale apo 90.36%. Prokuroria speciale rezulton të jetë prokuroria e vetme që ka arritur të procedoj numër më të lartë të kallëzimeve penale në raport me numrin e kallëzimeve penale të pranuar, respektivisht ka pranuar 281 kallëzime penale ndërsa ka proceduar 297 apo 105.69%;
3. Ngarkesa me lëndë, në fund të vitit 2019, rezulton me 1820 kallëzime penale, prej të cilave niveli më i lartë i adresohet veprave penale të Drogave me 944 kallëzime penale apo 51.87%, ndërsa Prokuroria themelore në Prishtinë me 882 kallëzime penale apo 48.46%, rezulton të ketë nivelin më të lartë të ngarkesës me lëndë;
4. Prokuroritë, përgjatë viteve 2013-2019, kanë pranuar 20167 persona (*në kallëzimet penale*), ndërsa kanë proceduar (*kryer/zgjidhur*), rastet e 19016 personave apo 94.29%. Vetëm dy (2) prokurori kanë proceduar më shumë persona në raport me numrin e personave të pranuar: Prokuroria speciale ka pranuar 1557 persona ndërsa ka proceduar 1994 persona apo 128.07% dhe Prokuroria themelore në Prizren ka pranuar 3056 persona ndërsa ka proceduar 3060 persona apo 100.13%;
5. Ngarkesa me persona (*në kallëzime penale*), në fund të vitit 2019, rezulton me 3395 persona, prej të cilëve numri më i lartë i adresohet veprave penale të Drogave me 1347 persona apo 39.68%, ndërsa Prokuroria themelore në Prishtinë me 1521 persona apo 44.80%, rezulton të ketë nivelin më të lartë të ngarkesës me persona;
6. Prokuroritë, përgjatë viteve 2013-2019, kanë proceduar (*kryer/zgjidhur*), rastet e 19016 personave, prej të cilëve nivelin më të lartë rezulton të kenë veprat penale të Drogave me 7061 persona të proceduar apo 37.13%. Sipas mënyrës së procedimit niveli më i lartë i adresohet aktakuzave me 11858 persona apo 62.38%, ndërsa për 3823 persona apo 20.10% janë hudhur kallëzimet penale si dhe për 3171 apo 16.68% persona janë pushuar hetimet. Rastet tjera të procedimit të personave i adresohen: Masa për trajtim të detyrueshëm psikiatrik për 16 persona apo 0.08%, Transferimi i procedurës penale në shtetin tjetër për 8 persona apo 0.04% dhe Bashkimi i procedurës penale për 140 persona apo 0.74%;

7. Hudhjet e kallëzimeve penale përbëjnë 3823 raste për persona apo 20.10% nga tërësia e resteve të proceduara për persona, prej të cilëve Korrupsioni përbën nivelin më të lartë me 1961 persona apo 51.29%, ndërsa Prokuroria themelore në Prishtinë me 1645 persona apo 43.03%, rezulton të ketë nivelin më të lartë të hudhjeve të kallëzimeve penale;
8. Masa për trajtim të detyrueshëm psikiatrik janë shqiptuar ndaj 16 personave, prej të cilëve Korrupsioni përbën nivelin më të lartë, me 5 persona apo 31.25%, ndërsa Prokuroria speciale me 5 persona apo 31.25% rezulton të ketë nivelin më të lartë të masave për trajtim të detyrueshëm psikiatrik;
9. Transferimi i procedurës penale në shtetin tjetër përfshinë 8 persona, prej të cilëve Drogat dhe Armët me nga 3 persona apo 37.50% përbëjnë nivelin më të lartë, ndërsa Prokuroria themelore në Prizren me 7 persona apo 87.50%, rezulton me nivelin më të lartë të transferimit të procedurës penale në shtetin tjetër;
10. Bashkimi i procedurës penale është bërë për 140 persona, prej të cilëve Korrupsioni përbën nivelin më të lartë me 64 persona apo 45.71%, ndërsa Prokuroria themelore në Prizren me 45 persona apo 32.61% rezulton të ketë nivelin më të lartë të bashkimit të procedurës penale;
11. Pushimi i hetimeve është zbatuar ndaj 3171 personave, prej të cilëve Korrupsioni përbën nivelin më të lartë me 1767 persona apo 55.72%, ndërsa Prokuroria themelore në Prishtinë me 903 persona apo 28.48% rezulton të ketë nivelin më të lartë të pushimit të hetimeve;
12. Aktakuzat për dhënien e urdhrit ndëshkimor janë ngritur ndaj 954 personave, prej të cilëve Drogat përbëjnë nivelin më të lartë me 794 persona apo 83.23%, ndërsa Prokuroria themelore në Prishtinë me 498 persona apo 52.20%, rezulton të ketë nivelin më të lartë të ngritjes së aktakuzave për dhënien e urdhrit ndëshkimor;
13. Aktakuzat e drejtpërdrejta janë ngritur ndaj 3935 persona, prej të cilëve Drogat përbëjnë nivelin më të lartë me 3142 persona apo 79.85%, ndërsa Prokuroria themelore në Prishtinë me 1088 persona apo 27.65%, rezulton të ketë nivelin më të lartë të ngritjes së aktakuzave të drejtpërdrejta;
14. Aktakuzat pas zhvillimit të hetimeve janë ngritur ndaj 6969 personave, prej të cilëve Drogat përbëjnë nivelin më të lartë me 2239 persona apo 32.13%, ndërsa Prokuroria themelore në Prishtinë me 1835 persona apo 26.33%, rezulton të ketë nivelin më të lartë të ngritjes së aktakuzave pas zhvillimit të hetimeve;

15. Subjektet e ndryshme, përgjatë viteve 2013-2019, kanë parashtruar nëpër prokurori⁴ 3012 Informata PPN me 4831 persona, prej të cilave rezultojnë se Institucionet e specializuara shtetërore kanë parashtruar 2659 Informata PPN apo 94.14%, me 3987 persona apo 91.96%, ndërsa qytetarët/të dëmtuarit kanë parashtruar 353 Informata PPN apo 5.87% me 844 persona apo 8.04%;
16. Prokuroritë, përgjatë viteve 2013-2019, kanë pranuar 4052 Informata PPN ndërsa kanë mbyllur 3498 Informata PPN apo 86.33%. Prokuroria themelore në Prishtinë rezultojnë të jetë prokuroria e vetme që ka arritur të procedojë numër më të lartë të Informatave PPN në raport me numrin e Informatave PPN të pranuar, respektivisht ka pranuar 1370 Informata PPN ndërsa ka proceduar 1402 apo 102.34%;
17. Ngarkesa me lëndë, në fund të vitit 2019, rezultojnë me 882 Informata PPN, prej të cilave niveli më i lartë i adresohet veprave të pretenduara penale të Korrupsionit me 524 Informata PPN apo 59.41%, ndërsa Prokuroria themelore në Prishtinë me 396 Informata PPN apo 44.90%, rezultojnë të ketë nivelin më të lartë të ngarkesës me lëndë;
18. Prokuroritë, përgjatë viteve 2013-2019, kanë pranuar 6440 persona (në Informatat PPN), ndërsa kanë mbyllur 5575 raste për persona apo 86.57%. Prokuroria themelore në Prishtinë ka arritur të mbyllë më shumë raste të personave në raport me numrin e personave të pranuar për persona, respektivisht ka pranuar 2228 persona ndërsa ka mbyllur rastet për 2243 persona apo 100.67%;
19. Ngarkesa me persona (në Informatat PPN), në fund të vitit 2019, rezultojnë me 1532 persona, prej të cilëve numri më i lartë i adresohet veprave penale të Korrupsionit me 1221 persona apo 66.64%, ndërsa Prokuroria themelore në Prishtinë me 645 persona apo 42.10%, rezultojnë të ketë nivelin më të lartë të ngarkesës me persona;
20. Policia e Kosovës rezultojnë të jetë subjekti me nivelin më të lartë të procedimit të kallëzimeve penale me persona nëpër prokurori përgjatë viteve 2013-2019, me gjithsej 9943 kallëzime penale dhe 15249 persona, ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Auditori Gjeneral me 5 Kallëzime penale me 6 persona;
21. Përgjatë viteve 2013-2019, Prokuroria themelore në Prishtinë ka pranuar numrin më të lartë të kallëzimeve penale (4320), ndërsa Prokuroria speciale ka pranuar numrin më të ulët të kallëzimeve penale (281). Prokuroria themelore në Prishtinë ka numrin më të lartë të kallëzimeve penale të proceduara (3694), ndërsa numrin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria speciale (297);

⁴ Shtatë (7) Prokuroritë themelore dhe Prokuroria speciale.

22. Përgjatë viteve 2013-2019, Prokuroria themelore në Prishtinë ka pranuar numrin më të lartë të personave (6794), ndërsa Prokuroria themelore në Gjakovë ka pranuar numrin më të ulët të personave (1054). Prokuroria Themelore në Prishtinë ka numrin më të lartë të rasteve të proceduara për persona (6001), ndërsa numrin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria themelore në Gjakovë (974);
23. Nivelin më të lartë të procedimit të kallëzimeve penale në raport me rastet e pranuar përgjatë viteve 2013-2019, rezultojnë të ketë Prokuroria speciale 103%, ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria themelore në Mitrovicë e cila ka proceduar 81% të kallëzimeve penale në raport me numrin e kallëzimeve penale të pranuar;
24. Nivelin më të lartë të procedimit të personave në raport me numrin e personave të pranuar në kallëzimet penale përgjatë viteve 2013-2019, rezultojnë të ketë Prokuroria speciale me 128%, ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria themelore në Mitrovicë e cila ka proceduar 83% të personave në raport me numrin e personave të pranuar;
25. Nivelin (%), më të lartë të hüdheve të kallëzimeve penale dhe pushimit të hetimeve në raport me rastet e proceduara për persona përgjatë viteve 2013-2019, rezultojnë të ketë prokuroria speciale me 50.10% nga tërësia e rasteve të proceduara për persona, ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria themelore në Ferizaj me 21.73%;
26. Nivelin (%), më të lartë të aktakuzave të ngritura në raport me rastet e proceduara për persona përgjatë viteve 2013-2019, rezultojnë të ketë prokuroria themelore në Ferizaj me 77.34%, ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë prokuroria speciale me 48.04%;
27. Nivelin (%), më të lartë të mbylljes së Informatave PPN në raport me rastet e pranuar përgjatë viteve 2013-2019, rezultojnë të ketë Prokuroria themelore në Prishtinë me 102.34%, ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria themelore në Mitrovicë me 50.88%;
28. Nivelin (%), më të lartë të mbylljes së rasteve për personat e përfshirë në Informatat PPN në raport me rastet e pranuar për persona përgjatë viteve 2013-2019, rezultojnë të ketë Prokuroria themelore në Mitrovicë me 43.59%.

6. REKOMANDIME

Prokuroria speciale:

- Të ngritë nivelin e efikasitetit në trajtimin dhe procedimin e kallëzimeve penale për veprat penale të Kontrabandimit me migrantë, Krimin të organizuar, Krimeve ekonomike dhe Nxitjes së urrejtjes. Ndërsa për rastet e personave kjo prokurori duhet të ngritë nivelin e trajtimit dhe procedimit të personave të përfshirë në veprat penale të Krimeve ekonomike.
 - Të ngritë nivelin e mbikqyrjes në marrjen e vendimeve për pushimin e hetimeve pasi që të dhënat tregojnë se nga tërësia prej 1994 rasteve të proceduara për persona përgjatë viteve 2013-2019, për 847 persona apo për 42.28%, janë pushuar hetimet. Niveli më i lartë i pushimit të hetimeve i adresohet Krimin të organizuar (299 persona apo 41.64% nga tërësia prej 718 personave të proceduar), Korrupsionit (299 persona apo 47.16% nga tërësia prej 634 personave të proceduar) dhe Shpërlarjes së parasë (113 persona apo 46.50% nga tërësia prej 243 personave të proceduar). Poashtu, hudhja e kallëzimit penal për 74 persona për veprën penale Shpërlarjes së parasë përbënë 30.45% të tërësisë së rasteve të procedura. Për më tej, hudhjet e kallëzimit penal dhe pushimi i hetimeve për shpërlarje të parasë përbëjnë 76.95% të tërësisë së rasteve të proceduara. Gjithë këtë shqyrtim e rëndon fakti se prokuroria speciale shumicën e e kallëzimeve penale i pranon nga Institucionet e specializuara shtetërore për hetimin e kryesve të veprave penale, ndërsa vetëm rreth 10% të rasteve i pranon nga qytetarët.
- | Prokuroria Speciale | % Hudhje & Pushim | % e aktakuza |
|---------------------|-------------------|--------------|
| Armët | 43% | 57% |
| Drogat | 47% | 53% |
| Kont.migrant | 36% | 64% |
| Krimi organizuar | 46% | 54% |
| Korrupsioni | 54% | 46% |
| Shpërlarja e parasë | 78% | 22% |
| Trafikimi me njerëz | 43% | 57% |
| Krimet ekonomike | 35% | 65% |
| Nxitja urrejtjes | 25% | 75% |
- Të përkushtohet në verifikimin dhe regjistrimin e lëndëve të Shpërlarjes së parasë dhe Korrupsionit në regjistrin PPN apo PP, për faktin se gjatë shtatë viteve (2013-2019), ngarkesa me lëndë (*Informata PPN*), i adresohet këtyre të grupeve. Gjersa të gjitha lëndët (100% të *Informatave PPN*), e pranuar për shpërlarje të parasë janë të parashtruara nga Institucionet shtetërore, në anën tjetër, mbi 50% të lëndëve (*Informatave PPN*), të pranuar për Korrupsion janë të parashtruara nga qytetarët.
 - Të ngritë efikasitetin në zvogëlimin e e ngarkesës, të pasqyruar më 31.12.2019, me rastet e Krimin të organizuar (34 raste me 177 persona), Korrupsionit (26 raste me 173 persona), Shpërlarje të parasë (28 raste me 89 persona) dhe Nxitje të urrejtjes (9 raste me 59 persona);

Prokuroria Themelore në Prishtinë:

- Të ngritë nivelin e efikasitetit në trajtimin dhe procedimin e kallëzimeve penale për veprat penale të Armëve, Drogave, Kontrabandimit me migrantë, Korrupsionit dhe Trafikimit me njerëz (*Krimeve ekonomike dhe Nxitjes së urrejtjes janë proceduar në kuotën mbi 100%*). Ndërsa për rastet e personave kjo prokurori duhet të ngritë nivelin e trajtimit dhe procedimit të personave të përfshirë në veprat penale të Armëve, Drogave,

Kontrabandimit me migrantë, Trafikimit me njerëz dhe Krimeve ekonomike (rastet tjera për persona janë proceduar në kuotën mbi 100%);

- Prokuroria Themelore në Prishtinë, nga viti 2016, ka të themeluar dhe të funksionalizuar Njësitin e specializuar për trajtimin e rasteve të Korrupsionit, Krimeve ekonomike përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Andaj, prokuroria themelore në Prishtinë duhet të përkushtohet në verifikimin dhe regjistrimin e saktë të lëndëve të Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike në regjistrin PP (kallëzimet penale) apo në regjistrin PPN (Informata), kjo për faktin se pas fillimit të zbatimit të planit strategjik për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike (në vitin 2016), është ndryshuar trendi i regjistrimit të lëndëve të këtyre natyrave nga regjistrimi në regjistrin PP në regjistrimin në regjistrin PPN. Për më tej, në fund të vitit 2019, ngarkesa me lëndë të Korrupsionit në regjistrin PPN rezulton të jetë me 283 Informata PPN me 495 persona, që rezulton të jetë më e lartë në raport me regjistrin PP, që rezulton me ngarkesën prej 104 Kallëzime penale me 336 persona. Ndërsa, ngarkesa me lëndët e Krimeve ekonomike në regjistrin PPN rezulton të jetë me 110 Informata PPN dhe 147 persona, ndërsa në regjistrin PP rezulton të jetë me 141 kallëzime penale dhe 201 persona.
- Trajtimi i rasteve të personave të përfshinë në veprat penale të Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike duhet të reflektoj në bazë të subjektit të parashtrimit të kallëzimeve penale. Kallëzimet penale të parashtruara nga Institucionet e specializuara shtetërore për hetimin e veprave penale të Korrupsionit dhe krimeve ekonomike, reflektojnë me faktet dhe provat e parashtruara në bazë të Kodit penal të Kosovës dhe Kodit të Procedurës penale, ndërsa kallëzimet penale të parashtruara nga qytetarët ka mundësi potenciale të mos reflektojnë me fakte dhe prova të mjaftueshme. Në këtë kontekst theksojmë se gjatë viteve 2013-2019, Institucionet shtetërore kanë parashtruar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë 81.94% të kallëzimeve penale dhe 79.11% të personave, ndërsa qytetarët kanë parashtruar 18.05% të kallëzimeve penale dhe 20.88% të personave. Ndërsa, rastet e Krimeve ekonomike të parashtruara nga Institucionet e specializuara shtetërore përbëjnë 97.51% të kallëzimeve penale dhe 97.51% të personave, ndërsa qytetarët kanë parashtruar 2.49% të kallëzimeve penale dhe 2.49% të personave. Mbi këto të dhëna të provuara theksojmë se Prokuroria themelore në Prishtinë përgjatë viteve 2013-2019, ka proceduar 2438⁵ persona në rastet e Korrupsionit, prej të cilëve për 1627 persona apo 67.26%, janë hudhur kallëzimin penal apo janë pushuar hetimet, ndërsa për 792 persona apo 32.74%, ka ngritur aktakuza. Për më tej, gjatë periudhës së njëjtë janë proceduar 1094⁶ persona në rastet e Krimeve ekonomike, prej të cilëve për 531 persona apo 44.81%, janë hudhur kallëzimin penal apo janë pushuar hetimet, ndërsa për 557 persona apo 51.19%, janë ngritur aktakuza.

PTh. Prishtinë	% Hudhje & Pushim	% e aktakuza
Armët	8%	92%
Drogat	16%	84%
Kont.migrant	17%	83%
Krimi organizuar		
Korrupsioni	67%	33%
Shpërlarja e parasë		
Trafikimi me njerëz	14%	86%
Krimet ekonomike	49%	51%
Nxitja urrejtjes	13%	87%

⁵ Rastet e korrupsionit për 19 persona janë proceduar në mënyrë tjetër (1627+792+19=2438).

⁶ Rastet e krimeve ekonomike për 6 persona janë proceduar në mënyrë tjetër (531+557+5=1094).

- Të ngritë efikasitetin në zvogëlimin e e ngarkesës, të pasqyruar më 31.12.2019, me rastet e Drogave (552 raste me 808 persona), Korrupsioni (104 raste me 336 persona), Trafikimi me njerëz (49 raste me 101 persona) dhe Krimet ekonomike (141 raste me 201 persona);

Prokuroria Themelore në Prizren:

- Të ngritë nivelin e efikasitetit në trajtimin dhe procedimin e kallëzimeve penale për veprat penale të Drogave dhe Nxitjes së urrjetjes (Krimeve ekonomike dhe Nxitjes së urrjetjes janë proceduar në kuotën mbi 100%). Ndërsa për rastet e personave kjo prokurori duhet të ngritë nivelin e trajtimit dhe procedimit të personave të përfshirë në veprat penale të Drogave, Kontrabandimit me migrantë, Shpërlarjes së parasë dhe Nxitjes së urrjetës (rastet tjera për persona janë proceduar në kuotën mbi 100%);
- Të ngritë nivelin e mbikqyrjes dhe udhëheqjes së ndjekjes penale ndaj institucioneve të zbatimit të ligjit, respektivisht ndaj Institucioneve parashtruese të Kallëzimeve penale për veprat penale Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike, duke përfshirë edhe ngritjen e nivelit të trajtimit të lëndëve të këtyre natyrave në prokurori. Kjo për faktin se, nga të gjitha rastet e proceduara për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike, vetëm rastet e Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike rezultojnë me kuotën negative në mes numrit të aktakuzave të ngritura ndaj personave në raport me numrin e rasteve, bashkërisht, të hudhjes së kallëzimeve penale për persona dhe pushimit të hetimeve. Respektivisht, për veprat penale të Korrupsionit ky raport rezulton me 57.80% të hudhjes apo pushimit të hetimeve për persona në raport me 42.20% të aktakuzave të ngritura për persona, ndërsa për rastet e Krimeve ekonomike rezulton se për 59.31% të personave janë hudhur apo pushuar hetimet, në raport me 40.69% të aktakuzave të ngritura. Për më tej, nga të dhënat për rastet e proceduara përgjatë viteve 2013-2019, rezulton se për personat e proceduar për veprat penale të Armëve raporti rezulton të jetë 85% aktakuza të ngritura për persona në raport me 15% të hudhjes dhe pushimit të hetimeve për persona; tek Drogat rezulton të jetë 88.55% aktakuza të ngritura në raport me 11.45% hudhje dhe pushim; tek Krimi organizuar rezulton të jetë 82.86% aktakuza të ngritura në raport me 7.14% hudhje dhe pushim; tek Trafikimi me njerëz rezulton me 57.78% aktakuza të ngritura në raport me 42.22% hudhje dhe pushim të hetimeve dhe për Nxitje të urrjetjes rezulton me 62.50% aktakuza të ngritura në raport me 37.50% hudhje apo pushim të hetimeve.

PTh.Prizren	% Hudhje & Pushim	% e aktakuza
Armët	15%	85%
Drogat	11%	89%
Kont.migrant	29%	71%
Korrupsioni	58%	42%
Trafikimi me njerëz	42%	58%
Krimet ekonomike	59%	41%
Nxitja urrjetjes	38%	62%

- Të ngritë efikasitetin në zvogëlimin e e ngarkesës, të pasqyruar më 31.12.2019, me rastet e Drogave (58 raste me 81 persona), Korrupsioni (25 raste me 80 persona) dhe Krimet ekonomike (22 raste me 37 persona);

Prokuroria Themelore në Pejë:

- Të ngritë nivelin e efikasitetit në trajtimin dhe procedimin e kallëzimeve penale për veprat penale të Drogave, Kontrabandimit me migrantë, Korrupsionit, Trafikimit me njerëz, Krimeve ekonomike dhe Nxitjes së urrejtjes (*nuk ka ndonjë vepër penale që është proceduar në kuotën mbi 100%*), ndërsa për personat e përfshirë në Drogat, Kontrabandimi me migrantë, Trafikimi me njerëz, Krimet ekonomike dhe Nxitja e urrejtes (*rastet tjera për persona janë proceduar në kuotën mbi 100%*);
- Të ngritë nivelin e mbikqyrjes dhe udhëheqjes së ndjekjes penale ndaj institucioneve të zbatimit të ligjit, respektivisht ndaj Institucioneve parashtruese të Kallëzimeve penale për veprat penale Korrupsionit, Trafikimit me njerëz, Krimeve ekonomike dhe Nxitjes së urrejtjes, duke përfshirë edhe ngritjen e nivelit të trajtimit të lëndëve të këtyre natyrave në prokurori. Kjo për faktin se, nga të gjitha rastet e proceduara (2013-2019), për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike, vetëm rastet e Korrupsionit, Trafikimit me njerëz, Krimeve ekonomike dhe Nxitjes së urrejtjes, rezultojnë me kuotën negative në mes numrit të aktakuzave të ngritura ndaj personave në raport me numrin e rasteve, bashkërisht, të hudhjes së kallëzimeve penale për persona dhe pushimit të hetimeve.

PTh. Pejë	% Hudhje & Pushim	% e aktakuza
Armët		
Drogat	13%	87%
Kont.migrant	30%	70%
Krimi organizuar		
Korrupsioni	67%	33%
Shpërlarja e parasë		
Trafikimi me njerëz	58%	42%
Krimet ekonomike	50%	50%
Nxitja urrejtjes	67%	33%

- Të ngritë efikasitetin në zvogëlimin e e ngarkesës, të pasqyruar më 31.12.2019, me rastet e Drogave (*44 raste me 65 persona*) dhe Krimet ekonomike (*20 raste me 32 persona*);

Prokuroria Themelore në Gjiilan:

- Të ngritë nivelin e efikasitetit në trajtimin dhe procedimin e kallëzimeve penale për veprat penale të Armëve, Drogave, Kontrabandimit me migrantë, Korrupsionit, Trafikimit me njerëz dhe Krimeve ekonomike (*Nxitja e urrejtjes është proceduar në kuotën mbi 100%*), ndërsa për personat e përfshirë në Armët, Drogat, Kontrabandimi me migrantë, Trafikimi me njerëz, Krimet ekonomike dhe Nxitja e urrejtes (*rastet tjera për persona janë proceduar në kuotën mbi 100%*);
- Të ngritë nivelin e mbikqyrjes dhe udhëheqjes së ndjekjes penale ndaj institucioneve të zbatimit të ligjit, respektivisht ndaj Institucioneve parashtruese të Kallëzimeve penale për veprat penale Korrupsionit, duke përfshirë edhe ngritjen e nivelit të trajtimit të lëndëve të këtyre natyrave në prokurori. Kjo për faktin se, nga të gjitha rastet e proceduara për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike, vetëm rastet e Korrupsionit rezultojnë me kuotën negative në mes numrit të aktakuzave të ngritura ndaj personave në raport me numrin e rasteve, bashkërisht, të hudhjes së kallëzimeve penale për persona dhe pushimit të hetimeve.

PTh. Gjiilan	% Hudhje & Pushim	% e aktakuza
Armët	11%	89%
Drogat	5%	95%
Kont.migrant	17%	83%
Krimi organizuar		
Korrupsioni	60%	40%
Shpërlarja e parasë		
Trafikimi me njerëz	18%	82%
Krimet ekonomike	29%	71%
Nxitja urrejtjes		

- Prokuroria themelore në Gjilan rezulton të ketë ngarkesën të ulët me lëndë (18 raste me 34 persona për të gjitha veprat penale karakteristike);

Prokuroria Themelore në Mitrovicë:

- Të ngritë nivelin e efikasitetit në trajtimin dhe procedimin e kallëzimeve penale për veprat penale të Armëve, Drogave, Kontrabandimit me migrantë, Korrupsionit, Trafikimit me njerëz, Krimeve ekonomike dhe Nxitjes së urrejtjes (nuk ka ndonjë vepër penale që është proceduar në kuotën mbi 100%), ndërsa për personat e përfshirë në Armët, Drogat, Kontrabandimi me migrantë, Korrupsioni, Krimet ekonomike dhe Nxitja e urrejtjes (rastet tjera për persona janë proceduar në kuotën mbi 100%);
- Të ngritë nivelin e mbikqyrjes dhe udhëheqjes së ndjekjes penale ndaj institucioneve të zbatimit të ligjit, respektivisht ndaj Institucioneve parashtruese të Kallëzimeve penale për veprat penale Kontrabandimit me migrantë, Korrupsioni dhe krimeve ekonomike, duke përfshirë edhe ngritjen e nivelit të trajtimit të lëndëve të këtyre natyrave në prokurori. Kjo për faktin se, nga të gjitha rastet e proceduara për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike, rastet e proceduara për persona për këto tre grupe të veprave penale rezultojnë me kuotë të përafërt në mes të aktakuzave të ngritura ndaj personave në raport me numrin e rasteve, bashkërisht, të hudhjes së kallëzimeve penale për persona dhe pushimit të hetimeve.
- Të ngritë efikasitetin në zvogëlimin e e ngarkesës, të pasqyruar më 31.12.2019, me rastet e Drogave (193 raste me 274 persona), Korrupsioni (76 raste me 125 persona), Trafikimi me njerëz (26 raste me 41 persona) dhe Krimet ekonomike (148 raste me 211 persona);

P.Th. Mitrovicë	% Hudhje & Pushim	% e aktakuza
Armët		
Drogat	11%	89%
Kont.migrant	47%	53%
Krimi organizuar		
Korrupsioni	44%	56%
Shpërlarja e parasë		
Trafikimi me njerëz	14%	86%
Krimet ekonomike	55%	45%
Nxitja urrejtjes		

Prokuroria Themelore në Ferizaj:

- Të ngritë nivelin e efikasitetit në trajtimin dhe procedimin e kallëzimeve penale për veprat penale të Drogave, Trafikimit me njerëz, Krimeve ekonomike dhe Nxitjes së urrejtjes (Armët, Kontrabandimi me migrantë dhe Korrupsioni janë proceduar në kuotën mbi 100%), ndërsa për personat e përfshirë në Armët, Drogat, Trafikimi me njerëz, Krimet ekonomike dhe Nxitja e urrejtjes (rastet tjera për persona janë proceduar në kuotën mbi 100%);
- Të ngritë nivelin e mbikqyrjes dhe udhëheqjes së ndjekjes penale ndaj institucioneve të zbatimit të ligjit, respektivisht ndaj Institucioneve parashtruese të Kallëzimeve penale për veprat penale Korrupsionit, duke përfshirë edhe ngritjen e nivelit të trajtimit të lëndëve të këtyre natyrave në prokurori. Kjo për faktin se, nga të gjitha rastet e proceduara për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike, vetëm rastet e Korrupsionit rezultojnë me kuotën e përafërt të procedimit të aktakuzave të ngritura ndaj personave në raport me numrin e rasteve, bashkërisht, të hudhjes së kallëzimeve penale për persona dhe pushimit të hetimeve.

PTH. Ferizaj	% Hudhje & Pushim	% e aktakuza
Armët	17%	83%
Drogat	6%	94%
Kont.migrant	17%	83%
Krimi organizuar		
Korrupsioni	46%	54%
Shpërlarja e parasë		
Trafikimi me njerëz	10%	90%
Krimet ekonomike	34%	66%
Nxitja urrejtjes		

- Prokuroria themelore në Ferizaj në zvogëlimin e ngarkesës, të pasqyruar më 31.12.2019, me rastet e Drogave (25 raste me 30 persona), Korrupsioni (15 raste me 44 persona) dhe Krimet ekonomike (17 raste me 41 persona);

Prokuroria Themelore në Gjakovë:

- Të ngritë nivelin e efikasitetit në trajtimin dhe procedimin e kallëzimeve penale për veprat penale të Armëve, Drogave, Kontrabandimit me migrantë, Korrupsionit, Trafikimit me njerëz dhe Krimeve ekonomike (Nxitja e urrejtjes është proceduar në kuotën mbi 100%), ndërsa për personat e përfshirë në Armët, Drogat, Kontrabandimi me migrantë, Trafikimi me njerëz dhe Krimet ekonomike (rastet tjera për persona janë proceduar në kuotën mbi 100%);
- Të ngritë nivelin e mbikqyrjes dhe udhëheqjes së ndjekjes penale ndaj institucioneve të zbatimit të ligjit, respektivisht ndaj Institucioneve parashtruese të Kallëzimeve penale për veprat penale Korrupsionit, duke përfshirë edhe ngritjen e nivelit të trajtimit të lëndëve të këtyre natyrave në prokurori. Kjo për faktin se, nga të gjitha rastet e proceduara për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike, vetëm rastet e Korrupsionit rezultojnë me kuotën e përafërt të procedimit të aktakuzave të ngritura ndaj personave në raport me numrin e rasteve, bashkërisht, të hudhjes së kallëzimeve penale për persona dhe pushimit të hetimeve.

PTH. Gjakovë	% Hudhje & Pushim	% e aktakuza
Armët	38%	62%
Drogat	11%	89%
Kont.migrant	30%	70%
Krimi organizuar		
Korrupsioni	51%	49%
Shpërlarja e parasë		
Trafikimi me njerëz	35%	65%
Krimet ekonomike	36%	64%
Nxitja urrejtjes		

- Të ngritë efikasitetin në zvogëlimin e ngarkesës të pasqyruar më 31.12.2019, me rastet e Drogave (66 raste me 79 persona), Korrupsioni (10 raste me 21 persona) dhe Krimet ekonomike (13 raste me 27 persona);

Rekomandim i përgjithshëm: Regjistrimi dhe gjenerimi i të dhënave statistikore për rasteve të reja (PP dhe PPN), në kuadër të subjektit parashtrues “E pranuar në kompetencë”, duhet të ndërpritet. Për më tej, të dhënat statistikore për Informatat PPN duhet të kategorizohen në: 1) Informata PPN të mbyllura për të cilat ka pushuar hetimi dhe 2) Informata PPN të mbyllura për shkak se të njëjtat kanë kaluar në regjistrin e kallëzimeve penale. Këto dy veprime do të ndikojnë në saktësinë e të dhënave lidhur me numrin real të rasteve të pranuar të reja.

KPK@ 2020

Hartues i raportit: Koordinatori nacional për Mekanizmin Përcjellës Ndërinstitucional